



PROCESVERBAL

për pranimin teknik të përkohshëm të punëve të kryera ne Projektin “Ndërtimi i kanalit për ujitje në fshatin RUDIC” Faza e parë

Procesverbali për pranimin teknik të përkohshëm të punëve të kryera në projektin “Ndërtimi i kanalit për ujitje në fshatin Rudic” faza e parë është përpiluar më datën **11.06.2019**, nga anëtarët e Komisionit për pranimin teknik të punëve të kryera , i cili më datën 31.05.2019, është formuar nga Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me anë të vendimit 07 Nr.320-21435/19.

Komisioni në përbërje prej Rexhep Rexhepi kryesues, Ndue Sheraj dhe Enver Mala anëtar më datën 11.05.2019, rreth orës 08:50, në prezencë të Organit Mbikëqyrës dhe përfaqësuesit të operatorit ekonomik Jetmir SHPK- Drenas ka dalë në vendpunisht për të bërë inspektimin e punëve të kryera.

Detyrë e Komision është ti inspektoi punët e kryera në vendpunisht dhe shqyrtimin e dokumentacionit investiv-teknik në bazë të së cilit është ndërtuar projekti i lartcekur.

Komisioni pas shikimit të dokumentacionit investiv-teknik ka konstatuar së investitor është Komuna e Klinës.

Punëkryesi “Jetmiri SHPK” dhe Autoriteti Kontraktues Komuna e Klinës më datën 09.11.2018, kanë lidhur kontratën nr. 01. Nr. 352-7495/18 (098/18) për “Ndërtimin e kanalit për ujitje në fshatin Rudic” faza e parë në vlerë prej 16.422,58 euro.

Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit investiv-teknik dhe inspektimit të punëve të kryera në vendpunisht ka konstatuar së punët janë kryer sipas projektit zbatues dhe vendimit për Revidimin e Projektit, andaj bije këtë :

KONKLUZË

Behët pranimin teknik i përkohshëm i punëve të kryera në Projektin “Ndërtimi i kanalit për ujitje në fshatin Rudic” faza e parë.

Komisioni inspektimin e punëve të kryera në vendpunisht e ka përfunduar rreth orës 09:20.

Menaxheri i Projektit

Naser Morina _____

Organi Mbikëqyrës :

1. Musa Gashi _____
2. Visar Bojaj _____
3. Enver Marmullaku _____

Komisioni :

1. Rexhep Rexhepi _____
2. Ndue Sheraj _____
3. Enver Mala _____